

VENDIM
Nr.402, datë 25.6.2004

**PËR NJË SHITESË DHE NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.605, DATË 13.10.2001 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KURSET E FORMIMIT PROFESIONAL TË
KUALIFIKIMIT E SPECIALIZIMIT NË AKADEMINË E POLICISË
“ARBEN ZYLYFTARI””**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4 të nenit 18 të ligjit nr.8553, datë 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, të pikës 3 të nenit 16 të ligjit nr.8643, datë 20.7.2000 “Për gradat në Policinë e Shtetit” dhe të nenit 7 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.605, datë 13.10.2001 të Këshillit të Ministrave, të bëhet shtesa dhe ndryshimi, si më poshtë vijon:

a. Pas shkronjës “a” të pikës 3/1 shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Për plotësimin organik me punonjës policie të rolit bazë, për vitin 2004-2005, në Akademinë e Policisë dhe në drejtoritë e policive në qarqe të organizohen kurse profesionale kualifikimi 3-mujore. Numri i kursantëve të përcaktohet nga drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit.”.

b. Në paragrafin e dytë, të pikës 11, fjalët “...normës 4,...”, zëvendësohen me “...normës 8...”.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Rendit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano